


PERCEPTIMET E  
QYTETARËVE  
TË PRIZRENIT PËR  
NDRYSHIMET  
KLIMATIKE





# PERCEPTIMET E QYTETARËVE TË PRIZRENIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Autor dhe Botues : EC Ma Ndryshe  
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &  
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5,  
Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi “Perceptimet e qytetarëve të Prizrenit për Ndryshimet Klimatike” është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që implementohet nga Community Development Fund – CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



# HYRJE

Ndryshimet klimatike tashmë janë bërë kërcënim për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe për ekonominë. Rritja e temperaturave po nxit degradimin e mjedisit, fatkeqësitë natyrore, ekstremet e motit, pasigurinë e ushqimit dhe ujit, përçarjen ekonomike, etj.

Miliarda ton CO<sub>2</sub> lirohen në atmosferë çdo vit si rezultat i prodhimit të qymyrit, naftës dhe gazit. Aktiviteti njerëzor po prodhon emetime të gazeve serrë në një nivel rekord, pa shenja të ngadalësimit. Sipas një raporti të Organizatës Botërore Meteorologjike (WMO) të shtatorit 2019, ne jemi të paktën një gradë Celsius mbi nivelet paraindustriale dhe afër asaj që shkencëtarët paralajmërojnë se do të ishte “një rrezik i papranueshëm”.<sup>1</sup>

Projeksionet klimatike të realizuara për Ballkanin Perëndimor përfshijnë ngrohje rajonale më të lartë se mesatarja botërore, veçanërisht për zonat malore; aty paraqitet një rënie në total e reshjeve vjetore, ku kemi uljen më të madhe të tyre në verë dhe rritje gjatë dimrit, veçanërisht në male, duke rezultuar pastaj me përmbytje më të shpeshta gjatë pranverës.<sup>2</sup>

Pra, Ballkani Perëndimor konsiderohet si një nga “hotspotet” e ndryshimeve klimatike në botë, i cili ka përjetuar rritje të motit ekstrem dhe ngjarjeve të lidhura me klimën. Kosova për shembull ka përjetuar rritje të temperaturave dhe valëve të të nxehtit që nga vitet 1960, shira të dendur të ndjekur nga përmbytjet që nga vitet 1980 dhe zjarre në pyje që nga vitet 2000. Thatësitrat janë regjistruar në vitet 1993, 2000, 2007, 2009 dhe 2012.<sup>3</sup>

Për fat të keq në Kosovë përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike mbetet sfidë pasiqë studimet specifike të vendit për trendet, parashikimet dhe ndikimet klimatike janë të kufizuara.

Problemet si shtimi i numrit të ndërtimeve të pakontrolluara që nga viti 1999, planifikimi i keqrrregulluar, shpyllëzimi dhe shfrytëzimi joadekuat i tokave bujqësore, menaxhimi i paqëndrueshëm i ujit, trajtimi i pamjaftueshëm i ujërave të zeza, energjia, transporti dhe mungesa e ndërgjegjësimit publik për mjedisin po kontribuojnë në degradim të mjedisit në tërë Kosovën, e të gjitha këto pastaj po komplikojnë klimën dhe do ndikojnë në ndryshimin e saj.

<sup>1</sup> <https://www.un.org/en/un75/climate-crisis-race-we-can-win#:~:text=Rising%20temperatures%20are%20fueling%20environmental,acidifying%2C%20and%20forests%20are%20burning.>

<sup>2</sup> [https://www.climatelinks.org/sites/default/files/asset/document/2021-03/2021\\_USAID\\_CDCCS-Annex-Kosovo.pdf](https://www.climatelinks.org/sites/default/files/asset/document/2021-03/2021_USAID_CDCCS-Annex-Kosovo.pdf)

<sup>3</sup> <https://kosovoteam.un.org/en/149874-one-worlds-hotspots-how-young-climate-ambassador-fights-climate-change-western-balkans#:~:text=Kosovo%20for%20example%20has%20been,%2C%202007%2C%202009%20and%202012.>

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është autoriteti përgjegjës për mjedisin dhe politikën klimatike në vend. Në kuadër të saj ekzistojnë dy plane/dokumente mbi ndryshimet klimatike: Strategjia e Ndryshimeve Klimatike 2018-2027 dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019-2021.

Në një raport të vitit 2014 të realizuar nga UNDP në bashkëpunim edhe me EC Ma Ndryshe thuhet se në komunën e Prizrenit sipas statistikave ka pasur sasi të lartë të emetimit të karbonit në ajër, ku kjo vlerë ka arritur në 1,370,821 tCO<sub>2</sub>eq.<sup>4</sup>

Në Prizren, trafiku është shkaku kryesor i ndotjes së ajrit dhe emetimeve të gazrave serrë për shkak të infrastrukturës rrugore jo të mirë dhe hapësirës së kufizuar për këmbësorët dhe biçikletat. Ndërtesat publike po ashtu nuk janë efikase në energji pasi që përdoret lëndë djegëse ndotëse për ngrohje dhe energji elektrike, duke shtuar edhe zonën industriale afër Prizrenit e cila emeton sasi të konsiderueshme të gazeve serrë. Në këtë grup të problematikave në Prizren hyjnë edhe menaxhimi jo i mirë i mbeturinave dhe sektori i shërbimeve.<sup>5</sup>

Për të analizuar "Perceptimet e qytetarëve të Prizrenit për Ndryshimet Klimatike" EC Ma Ndryshe ka realizuar hulumtimin me anë të anketave. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të vlerësohen njohuritë e qytetarëve mbi ndryshimet klimatike dhe problemet tjera mjedisore që mund të ndikojnë tek ta. Njëkohësisht do të identifikohet se si ndihen ata mbi këto probleme mjedisore dhe se sa janë të gatshëm të fillojnë ndryshimin që nga vetja.


Ky hulumtim është realizuar me 147 qytetarë, nga të cilët 77 ishin gra dhe 70 burra. Lagjet në të cilat është zhvilluar anketa janë këto: Arbanë, Bajram Curr, Bazhdarhane, Dardani, Hoçamahallë, Jeni Mahallë, Jeta e Re, Kurillë, Lakuriq, Ortakoll, Petrovë, Qendra Historike, Ralin, Tabahane, Terzimahallë dhe Tusuz.

<sup>4</sup> [https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Environment/Strategji%20per%20ndryshimet%20klimatike%202014\\_2024.pdf](https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Environment/Strategji%20per%20ndryshimet%20klimatike%202014_2024.pdf),


[https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/SNK\\_PVVK\\_\\_5%20tetor\\_2018\\_Final%5B1%5D.pdf](https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/SNK_PVVK__5%20tetor_2018_Final%5B1%5D.pdf)

<sup>5</sup> [https://www.undp.org/kosovo/projects/support-sustainable-prizren-%E2%80%93-initiating-urban-nationally-appropriate-mitigation-actions-project?fbclid=IwAR0vQhJTjp5jL\\_RFeHAc6Vifev8Y\\_2L-6i7MUPBUh0TWZdIEsG4GqsnW1gQ](https://www.undp.org/kosovo/projects/support-sustainable-prizren-%E2%80%93-initiating-urban-nationally-appropriate-mitigation-actions-project?fbclid=IwAR0vQhJTjp5jL_RFeHAc6Vifev8Y_2L-6i7MUPBUh0TWZdIEsG4GqsnW1gQ)

## NGA OPSIONET E MË POSHTME ZGJIDH TRE PROBLEMET MJEDISORE QË TË SHQETËSOJNË MË SË SHUMTI:




## A KENI VËREJTUR NDRYSHIME MJEDISORE SI P.SH : NDRYSHIMET NË RESHJE, TEMPERATURË, NDËRRIMIN E STINËVE, PËRMBYTJET DHE THATËSIRAT KËTO 10 VITET E FUNDIT NË QYTETIN TUAJ?




## A KENI DËGJUAR NDOJËHERË PËR "NDRYSHIMET KLIMATIKE"?




## NËSE PO, KU KENI DËGJUAR PËR ATO?



## A MENDONI SE JENI MJAFTUESHËM TË INFORMUAR SA I PËRKETË SITUATËS ME NDRYSHIMET KLIMATIKE?




## SA E RËNDËSISHME ËSHTË SITUATA ME NDRYSHIMET KLIMATIKE PËR JUVË PERSONALISHT?




## A MENDONI SE NDRYSHIMET KLIMATIKE DO TË KENË EFEKT TË MENJËHERSHËM APO TË MËVONSHËM TEK NE?




## A MUND TË BËHET DIÇKA PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS LIDHUR ME NDRYSHIMET KLIMATIKE?




## KUSH MENDONI SE ËSHTË PËRGJEGJËS KRYESOR SA I PËRKET PËRMIRËSIMIT TË KËSAJ SITUATE?




## A KENI NDËRMARRË JU NDOJËHERË NDOJË MASË KUNDREJT NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, APO A KENI MARRË PJESË NË NDOJË AKSION NË LIDHJE ME KËTË ÇËSHTJE?



## NËSE PO, TREGONI NDONJË SHEMBULL?



## CILAT NGA AKTIVITETET E LISTUARA MË POSHTË TË CILAT KANË NDIKIM POZITIV SA I PËRKET NDRYSHIMEVE KLIMATIKE I BËNI MË SHPESH JU PERSONALISHT?





# PËRFUNDIME

Qytetarët e Prizrenit në përgjithësi kanë vërejtur ndryshimet në klimë dhe e shohin këtë situatë si një dukuri që do të ketë pasoja të mëvonshme tek ta.

Nga një listë me gjithsej 12 probleme, secili qytetar ka zgjedhur tre nga ato që i konsiderojnë më të dëmshme ndaj mjedisit dhe shëndetit të tyre. Problemet që janë konsideruar nga qytetarët si më shqetësuese kanë qenë mbeturinat me 28.4%, ndotja e ajrit dhe trafiku me 37.3% dhe ndotja e ujërave me 16.6%. Ndërsa në anën tjetër si më pak të rëndësishme nga ana e qytetarëve janë parë efekti serrë (0.8%) mbipopullimi e mbikonsumimi (1%) dhe hollimi i shtresës së ozonit (0.3%).

Qytetarët në vazhdim janë pyetur se a kanë vërejtur ndryshime mjedisore si: ndryshimet në reshje, në ndrrimin e stinëve, përmbytje e thatësira, në këtë rast 83% e tyre janë përgjigjur se po kanë vërejtur ndryshime të tilla, 7.5% kanë thënë që jo, ndërsa 9.5% prej tyre i janë përgjigjur opsionit “nuk e di”

Në pyetjen se a kanë dëgjuar ndonjëherë për ndryshimet klimatike, 83.7% e qytetarëve kanë treguar se po kanë dëgjuar, 10.9% e tyre nuk kanë dëgjuar, ndërsa 5.4% e tyre janë përgjigjur me “nuk e di”. Qytetarët të cilët kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike më tutje kanë treguar se si mjete informuese për ta kanë shërbyer, televizioni dhe radio me 45.6%, interneti (rrjetet sociale dhe

portalet) me 29.6%, institucionet arsimore me 16% dhe dy kategoritë tjera, grupet e ambientalistëve dhe OJQ-të së bashku me kategorinë miqtë dhe familjarët me 8.8%.

16.3% e qytetarëve të anketuar kanë treguar se janë mjaftueshëm të informuar sa i përket situatës me ndryshimet klimatike, 57.8% e tyre kanë thënë se janë deri diku të informuar ndërsa 25.9% kanë treguar se jo nuk janë mjaftueshëm të informuar.

Nga rezultatet e hulumtimit del se qytetarët ndryshimet klimatike i kanë vlerësuar në përgjithësi të rëndësishme, pasi që për 48.3% të tyre situata me ndryshimet në klimë është shumë e rëndësishme, për 41.5% është deri diku e rëndësishme ndërsa për 7.5% të qytetarëve kjo situatë nuk është aq e rëndësishme, e vetëm për 2.7% të qytetarëve të anketuar kjo situatë nuk është aspak e rëndësishme.

Efekti i ndryshimeve në klimë është i pashmangshëm andaj është parë e arsyeshme që të merret mendimi i qytetarëve se a do ketë efekt të menjëhershëm apo të mëvonshëm ndryshimi i klimës tek ne. Në këtë rast, 26.5% e qytetarëve mendojnë se ndryshimet klimatike do të kenë efekt të menjëhershëm, 36.7% e tyre mendojnë se ky efekt do ndihet më vonë, vetëm 4.1% kanë thënë se nuk do ketë fare efekt dhe 32.7% kanë zgjedhur opsionin “nuk e di”.

Sa i përket parandalimit të gjendjes së krijuar, 49% e qytetarëve kanë shprehur se mund të merren masa parandaluese, 11.6% kanë thënë se jo nuk mund të bëhet asgjë për të përmirësuar këtë gjendje dhe 39.5% të tjerë kanë qëndruar asnjëanës duke u përgjigjur me opsionin “nuk e di”.

Po ashtu në kuadër të këtij hulumtimi qytetarët janë pyetur se kush është përgjegjës kryesor sa i përket përmirësimit të situatës së krijuar me ndryshimet në klimë. 40.1% e qytetarëve janë shprehur se përgjegjës janë qeverisja qendrore dhe ajo lokale, 37.4% të tjerë kanë thënë se përgjegjës jemi secili individ, ndërsa opsioni vendet e zhvilluara industriale është zgjedhur nga 8.2%, bizneset dhe industritë nga 4.1%, organizatat mjedisore ndërkombëtare nga 6.8% dhe OJQ-të lokale nga 2.7% qytetarë të tjerë.

Më tutje qytetarët janë pyetur se a kanë marrë ndonjëherë ndonjë masë kundrejt ndryshimeve klimatike apo a kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet lidhur me këtë çështje, ku del se 63.3% e qytetarëve të anketuar nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla, 14.3% e tyre janë përgjigjur me opsionin “nuk e di” dhe vetëm 22.4% e tyre janë përgjigjur me “po”. Qytetarët që janë përgjigjur me “po” në vazhdim janë pyetur se në çfarë aktivitete janë angazhuar, ku përgjigjet më të shpeshta nga ana e tyre kanë qenë: aksionet e pastrimit, mbjellja e luleve dhe fidaneve në oborre dhe hapësira publike, pjesëmarrja e tyre në debate të organizuara nga komuna, kursimi i energjisë dhe mos përdorimi i qeseve të plastikës.

Qytetarët gjatë anketimit kanë pasur mundësinë të tregojnë edhe zakonet e tyre të përditshme që kanë efekte të mira në mjedis, në këtë rast 34% e qytetarëve kanë treguar se i fikin dritat kur nuk i nevojiten, 16.3 % e tyre përdorin transportin publik, 14.3% mbjellin fidane, 12.9% e qytetarëve shkojnë në punë me biçikletë, 9.5% të tjerë blejnë poça eficient dhe 7.5% blejnë ushqim organik dhe vendor.

# REKOMANDIME

Fatkeqësitë e lidhura me klimën dhe ekstremet e motit kanë qenë gjithmonë pjesë e sistemit të jetës në Tokë. E me rritjen e temperaturës së tokës, viteve të fundit ato po bëhen më të shpeshta dhe intensive. Asnjë kontinent nuk ka mbetur i paprekur nga valët e të nxehtit, thatësitat, tajfunët dhe uraganet, që po shkaktojnë shkatërrim masiv në mbarë botën.

Shkenca na thotë se ndryshimi i klimës është i pakundërshtueshëm, por në të njëjtën kohë ajo gjithashtu na thotë se nuk është tepër vonë për të frenuar këtë problem.

Industria, transporti, ndërtimet, bujqësia dhe energjia janë ndotësit që lirojnë sasinë më të madhe të gazrave serrë në Kosovë. Për të parandaluar situatën e krijuar me ndryshimet klimatike ne duhet të përdorim më shumë energji të pastër dhe në mënyrë më efikase. Ndryshimi duhet të nis nga e gjithë shoqëria – përfshirë këtu qeveritë lokale, qendrore dhe ndërkombëtare. Institucionet përkatëse duhet të investojnë në infrastrukturë më të mirë, duhet të rrisin monitorimin dhe inspektimin, në të mirë të mjedisit dhe të promovojnë sa më shumë metoda ekologjike, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Në të njëjtën kohë duke parë që hulumtimet sa i përket çështjeve mjedisore dhe situatës me ndryshimet klimatike në vend janë të mangëta, rekomandohet që të rritet fokusi dhe të investohet më shumë në këtë aspekt.

Mungesa e informacioneve mbi ndryshimet klimatike është një tjetër shqetësim që del në pah nga ky hulumtim. Sipas statistikave të nxjerra, kur qytetarët janë pyetur se ku kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike, institucionet arsimore kanë qenë opsioni më pak i zgjedhur. Në Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Kosovës, fusha e mjedisit është shumë mirë e rregulluar, por përsëri duhet punuar më shumë në këtë aspekt, pasi që institucionet e arsimit janë bazë e edukimit. Prandaj trajnimi i edukatorëve dhe mësimeve për këto çështje duhet të jetë prioritet, duke mos lënë anash as punën me të rinjtë dhe përfshirjen e tyre në aktivitete e aksione për parandalimin e ndryshimeve klimatike.

Shumica e të anketuarve kanë treguar që përgjegjësia për përmirësimin e kësaj situatë i takon secilit individ. Të gjithë ne mund të bëjmë ndryshim duke nisur nga krijimi i shprehive të përditshme, si fikjen e dritave kur nuk na duhen, përdorimin e poçave eficient, ngasjen e biçikletave, përdorimin e transportit urban, konsumimin e ushqimeve organike dhe atyre vendore, e shumë akte të tjera që na dërgojnë drejt mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit.

Andaj promovimi i këtyre shprehive, vetëdijesimi i qytetarëve mbi rëndësinë e tyre dhe përfshirja direkte e qytetarëve në iniciativa të tilla nga institucionet dhe grupet përkatëse të shoqërisë është një nga proceset më të lehta për tu realizuar.

## PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

**1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizates janë:

**1.** Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

**2.** Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;

**3.** Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe

**4.** Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.